

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryetar, Ramë Hyseni dhe Isa Shala anëtarë, në çështjen juridike të paditëseve V.S. dhe M.S., të cilat i përfaqëson përfaqësuesi i tyre ligjor-i ati Xh.S. nga Klina, e që të gjithë i përfaqëson avokati A.N. nga Peja, ndaj të paditurave Kompania e Sigurimeve “NN1”, të cilën e përfaqëson e autorizuar SH.G. dhe Kompania e Sigurimeve “NN2”, në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari F.A., në çështjen për kompensim të dëmit, vlera e kontestit 32,000.00 euro, duke vendosur lidhur me ankesat e të autorizuarve të paditurave, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, C.nr.273/11 të datës 21.05.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **23.05.2016**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohen pjesërisht ankesat e të paditurave **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, C.nr.273/11 i datës 21.05.2013 dhe gjykohet si vijon:

LPJESËRISHT APROVOHET kërkesë padia e paditëseve V.S. dhe M.S., **si e bazuar,**

I.1 Detyrohet e paditura K.S. “NN1”, në Prishtinë, rr. ..., që paditëses së parë V.S., në emër të dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të dt.17.01.2009, t’ia paguaj dëmshpërblimin dhe atë për:

- a), Dhembjet e përjetuara fizike në shumën prej 1,275.00 euro,
- b), Zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumën prej 1,875.00 euro,
- c), Frikë të përjetuar në shumën prej 1,125.00 euro dhe
- d), Shëmtimin në shumën prej 1,875.00 euro,

I.2 Detyrohet e paditura e parë K.S. “NN1”, që paditëses së dytë M.S., në emër të dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të dt.17.01.2009, t’ia paguaj dëmshpërblimin dhe atë për:

- a), Zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumën prej 12,000.00 euro dhe
- b), Frikë në shumën prej 2,250.00 euro,

I.3. Detyrohet e paditura e dytë K.S. “NN2”, që paditëses së parë V.S., në emër të dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të dt.17.01.2009, t’ia paguaj dëmshpërblimin dhe atë për:

- a), Dhembjet e përjetuara fizike në shumën prej 425.00 euro,
- b), Zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumën prej 625.00 euro,
- c), Frikë të përjetuar në shumën prej 375.00 euro dhe
- d), Shëmtimin në shumën prej 625.00 euro,

I.4. Detyrohet e paditura e dytë K.S. “NN2”, që paditëses së dytë M.S., në emër të dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të dt.17.01.2009, t’ia paguaj dëmshpërblimin dhe atë për:

- a), Zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumën prej 4,000.00 euro dhe
- b), Frikë në shumën prej 750.00 euro,

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditëseve, mbi lartësitë e shumave të aprovuara në pikën një (I.) të dispozitivit dhe atë:

II.1 Kërkesa e paditëses së parë V.S., që të detyrohen e paditura e parë K.S. “NN1” dhe e paditura e dytë K.S. “NN2” që paditëses t’ia paguaj dëmshpërblimin dhe atë për:

- a), Dhembjet e përjetuara fizike në shumën prej 1,300.00 euro,
- b), Zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumën prej 2,500.00 euro,
- c), Frikë të përjetuar në shumën prej 1,000.00 euro dhe
- d), Shëmtimin në shumën prej 1,000.00 euro,

II.2 Kërkesa e paditëses së dytë M.S., që të detyrohen e paditura e parë K.S. “NN1” dhe e paditura e dytë K.S. “NN2” që paditëses t’ia paguaj dëmshpërblimin dhe atë për:

- a), Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumën prej 14,000.00 euro dhe
- b), Frikë në shumën prej 1,000.00 euro,

III. DETYROHET e paditura K.S. “NN1”, në Prishtinë, rr. “...”, që paditëseve të ju paguaj shumat e cekura në pikën **I si dhe në pikën V** (sa i përket pjesës vërtetuese të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, C.nr.273/11 të datës 21.05.2013) të dispozitivit të këtij aktgjykimi: paditëses së parë V.S. për të gjitha llojet e dëmit jomaterial shumën e përgjithshme prej 6,150.00 euro, (gjashtëmijë e njëqind e pesëdhjetë euro), paditëses së dytë M.S. për të gjitha llojet e dëmit jomaterial shumën e përgjithshme prej 20,250.00 euro (njëzetmijë e dyqind e pesëdhjetë euro), të gjitha me kamatën si për mjetet e afatizuara në bankat komerciale në R. e Kosovës, për një vit pa destinim të posaçëm, nga datë 21.05.2013, deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

IV. DETYROHET e paditura K.S. “NN2”, në Prishtinë, që paditëseve të ju paguaj shumat e cekura në pikën **I si dhe në pikën V** (sa i përket pjesës vërtetuese të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, C.nr.273/11 të datës 21.05.2013) të dispozitivit të këtij aktgjykimi: paditëses së parë V.S. për të gjitha llojet e dëmit jomaterial shumën e përgjithshme prej 2,050.00 euro, (dy mijë e pesëdhjetë euro), paditëses së dytë M.S. për të gjitha llojet e dëmit jomaterial shumën e përgjithshme prej 6750.00 euro (gjashtëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë euro), të gjitha me kamatën si për mjetet e afatizuara në bankat në R. e Kosovës, për një vit pa destinim të posaçëm, nga datë 21.05.2013, deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

V. VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, C.nr.273/11 i datës 21.05.2013, si në pikën II. ku detyrohet e paditura e parë K.S. “NN1”, që paditëses së dytë M.S., në emër të dëmit jo material ti paguaj për dhembjet e përjetuara fizike shumën prej 2,625.00 euro dhe shëmtimin 3,375.00 euro, në pikën IV. ku detyrohet e paditura e dytë K.S. “NN2”, që paditëses së dytë M.S., në emër të dëmit jo material t’ia paguaj për dhembjet e përjetuara fizike 875.00 euro dhe shëmtimin 1,125.00 euro, në pikën V. ku detyrohen të paditurat që paditëseve në emër të shpenzimeve kontestimore t’ua paguajnë shumën prej 5,200.00 euro, dhe atë e paditura K.S. “NN1”, shumën prej 4,000.00 euro dhe

K.S. "NN2", shumën prej 1,200.00 euro, si dhe sa i përket pjesës refuzuese të aktgjykimit të atakuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.273/11 të datës 21.05.2013, ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve të mitura V.S. dhe M.S., me vendbanim në Klinë dhe në pikën I detyrohet e paditura K.S. "NN1", në Prishtinë, rr. ..., që paditëses së parë V.S., në emër të dëmit jo material dhe material sipas aksidentit të komunikacionit të dt.17.01.2009, e nga baza e auto përgjegjësishë t'ia paguaj shumën e përgjithshme në lartësi prej 10.500 euro, dhe atë për: dhembjet e përjetuara fizike 2.250 euro, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 3.750 euro, frikë të përjetuar 1.875 euro dhe shëmtim 2.625 euro. në pikën II detyrohet e paditura e parë K.S. "NN1", që paditëses së dytë M.S., në emër të dëmit jo material dhe material sipas aksidentit të komunikacionit të dt.17.01.2009, nga baza e auto përgjegjësishë t'ia paguaj shumën e përgjithshme në lartësi prej 31.500 euro, dhe atë: për dhembjet e përjetuara fizike 2.625 euro, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 22.500 euro, frikë 3.000 euro dhe shëmtimin 3.375 euro. Në pikën III detyrohet e paditura e dytë K.S. "NN2", që paditëses së parë V.S., në emër të dëmit jo material dhe material sipas aksidentit të komunikacionit të dt.17.01.2009, nga baza e auto përgjegjësishë t'ia paguaj shumën e përgjithshme në lartësi prej 3.500 euro, dhe atë për: dhembjet e përjetuara fizike 750 euro, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 1.250 euro, frikë 625 euro dhe shëmtimin 875 euro. Në pikën IV detyrohet e paditura e dytë K.S. "NN2", që paditëses së dytë M.S., në emër të dëmit jo material dhe material sipas aksidentit të komunikacionit të dt.17.01.2009, e nga baza e auto përgjegjësishë t'ia paguaj shumën e përgjithshme në lartësi prej 10.500 euro, dhe atë për: dhembjet e përjetuara fizike 875 euro, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 7.500 euro, frikë 1.000 euro dhe shëmtimin 1.125 euro. Shumat e gjykuara të dëmit jo material dhe material nga pika I, II, III, IV të dispozitivit paditëseve të mitura do tu paguhen nëpërmes përfaqësuesit të tyre ligjor-babait të Xh.S. nga Klina. Kompensimet e precizuara më sipër të dëmit jo material dhe material detyrohen të paditurat që ti përmbushin me kamatë të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë, për mjetet e deponuara të klientëve mbi 1 vit, pa destinim dhe afatizim të caktuar sipas normës prej 3.5%, duke filluar nga dita e vendosjes (21.05.2013) e deri në vendosjen definitive, ndërsa në pikën V detyrohen të paditurat që paditëseve në emër të shpenzimeve kontestimore t'ua paguajnë shumën prej 5.200 euro, dhe atë e paditura K.S. "NN1", shumën prej 4.000 euro dhe K.S. "NN2", shumën prej 1.200 euro, krejt këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëseve në lartësi prej 1.500 euro, e që ka të bëjë më dëmin material: për paditësen Vera Selimi shuma e tërësishme prej 450 euro dhe atë për shpenzime të mjekimit 150 euro, ndihmë dhe kujdes të huaj 100 euro, ushqim të përforcuar 150 dhe veshmbathje 50 euro, si dhe për paditësen Mimoza Selimi shumën e tërësishme prej 1.050 euro, dhe atë për shpenzime të mjekimit 200 euro, ndihmë dhe kujdes të huaj 400 euro, ushqim të përforcuar 400 euro dhe veshmbathje 50 euro.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i të paditurës së parë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë si gjykatë e instancës, që ankesën si të

tillë ta aprovoj, aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjore ka paraqitur ankesë i autorizuari i të paditurës së dytë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të priset aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, më aktgjykimin C.nr.273/11 të datës 21.05.2013 dhe çështja kthehet në rigjykim apo të ndryshohet aktgjykimi dhe gjykata e shkallës së dytë të vendosë vet lidhur me kërkesëpadinë.

Përgjigje në ankesën e të paditurës së dytë ka paraqitur i autorizuari i paditëseve duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, që pas shqyrtimit të kësaj përgjigje në ankesë si dhe shkresat e lëndës kontestimore, ankesën e të paditurës ta refuzoj si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë C.nr.273/11 të datës 21.05.2013, ta vërtetoj si të drejtë dhe të ligjshëm.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe gjeti se:

-Ankesat janë pjesërisht të themelta

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditëset kanë ushtruar padi ndaj të paditurave me kërkesë për kompensim dëmi. Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës kryesore dhe administrimit të provave vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar duke u bazuar në nenet 178, 200, 319 dhe 192 të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata është bazuar në nenin 452 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së.

Vlerësimet juridike të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullta dhe të bazuara në ligj pjesërisht i aprovon edhe kjo gjykatë, sepse aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, të cilat gjykata e shkallës së dytë i vështron sipas detyrës zyrtare, po ashtu nuk ekzistojë shkelje esenciale të cilat i pretendon pala e paditur.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë rregullisht dhe në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen në këtë çështje juridike.

Mirëpo për kundër vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale, përkitazi me aspektet e dëmit jo material dhe vlerësimin të lartësisë së aprovuar, duke aprovuar shumat tepër të larta të cilat nuk janë përputhje me qëllimin e kompensimit të dëmit, andaj Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, natyrën lëndimeve, moshën e paditëseve, ka gjykuar shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në emër të shpërblimit të dëmit jo-material, si shpërblim i drejtë dhe se shumat e aprovuara paraqesin një formë të satisfacionit që paditëset me këto mjete të plotësoj nevojat dhe të mirat materiale të dëmtuara, që përndryshe nuk paraqesin si shpërblim absolut të dëmit, ngase gjykata është e vetëdijshme se paditëset për asnjë çmim nuk do të praninin pasojat e aksidentit.

Gjykata e Apelit duke marrë parasysh të gjitha provat e administruara në këtë çështje juridike, raportin e aksidentit të përpiluar nga policia, ekspertizat mbi aksidentin e komunikacionit nga ekspertët Sejdi Berisha dhe Ylli Koshi, mendimit të dhënë të përbashkët të këtyre dy ekspertëve në seancën e datës 20.12.2012, si dhe super ekspertizës mbi aksidentin e komunikacionit të punuar nga grupi i ekspertëve Njazi Ibrahim, Mevlan Bixhaku dhe Gëzim Hoxha e datës 13.03.2013, ka ardhur në përfundim se në rastin konkret si shkaktar dhe kontribues të aksidentit kanë qenë edhe automjeti i udhëtarëve Passat me targa të regjistrimit 434 KS 613, i siguruar të e paditura e parë, po ashtu edhe vetura e udhëtarëve Golf me targa regjistrimi 416 KS 251, e cila ka qenë e siguruar te e paditura e dytë.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar vendosjen nga ana e gjykatës së shkallës së parë lidhur me ndarjen e përgjegjësisë me rastin e shkakimit të aksidentit e si pasojë edhe bartjen e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit nga kompanitë e sigurimeve të cilat janë të paditura në këtë çështje, ashtu që vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë për ndarjen e përgjegjësisë me rastin e shkakimit të aksidentit në 75 % kontribut për drejtuesin e automjetit i siguruar te e paditura e parë KS “NN1” dhe 25% për drejtuesin e automjetit i siguruar te e paditura e dytë KS “NN2”, e vlerëson si të drejtë edhe gjykata e shkallës së dytë, pasi me këtë ndarje të përgjegjësisë janë pajtuar edhe ekspertët Ylli Koshi dhe Sejdi Berisha, në mendimin e dhënë në seancën e datës 20.12.2012, ndërsa nëse marrim për bazë përshkrimin e lëshimeve nga të dy drejtuesit e automjeteve Passat dhe Golf si në super ekspertizën e punuar nga grupi i ekspertëve të datës 13.03.2013, të cilët ndonëse nuk kanë caktuar ndonjë shkallëzim në ndarje të përgjegjësisë në përqindje (%) mund të konkludojmë se nga konstatimi për lëshimet e të dy ngasësve të automjeteve, lëshimet e ngasësit të automjetit Passat kanë qenë primare dhe në asnjë mënyrë nuk ka guxuar ti ndërmarr, me vetë faktin se automjeti Passat ka ndërmarrë veprimin e lëvizjes mbrapa përgjatë mesit të rrugës me çka i ka pamundësuar drejtuesit të automjetit Golf shmangien e goditjes, po ashtu drejtuesi i automjetit Passat nuk ka sinjalizuar me katër tregues sipas rregullave të komunikacionit për të lëvizur mbrapa, që i ka pamundësuar drejtuesit të veturës Golf të vërejë me kohë se i njëjti është duke lëvizur mbrapa, andaj lëshimet e veturës Passat janë primare në raport me lëshimet e veturës Golf, i cili në rastin konkret ka lëvizur me shpejtësi më të lartë se ka qenë e lejuar, si dhe nuk ka marr veprime të nevojshme duke nënvlerësuar situatën të cilat e bëjnë përgjegjës për aksidentin, andaj duke marr parasysh edhe lëshimet e përshkruara nga grupi i ekspertëve në super ekspertizën e datës 13.03.2013, mund të arrijmë në përfundim se ndarja e përgjegjësisë në primare dhe sekondare apo në raportin 75% me 25 %, me qëllim të përlllogaritjes së dëmit të shkakuar dhe ndarjes së tij në raport me të paditurat për kompensim të paditëseve në proporcionin 75% me 25% është i drejtë.

Gjykata e Apelit me rastin e ndryshimit të aktgjykimit të shkallës së parë dhe vendosjes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, lidhur me lartësinë e dëmit jo material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 LPK-së, dhe në kuptim të dispozitave të nenit 178 paragrafi 1 dhe 2, 186, 189 paragrafi 2, 190, 192 dhe 200 të LMD-së¹, duke u bazuar në mendimin e ekspertëve mjekësor dr. Bujar Kastrati neurokirurg në QKUK, i cili mendimin e tij e ka dhënë në seancën e datës 25.11.2009, si dhe dr. Muhamet Haliti neuropsikiatër, i cili mendimin e tij e ka dhënë në seancën e datës 30.11.2012, mendimin e të cilëve i vlerësoi në tërësi si profesional dhe objektiv.

¹ LMD-së-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978,

Gjykata për paditësen Vera Selimi, me rastin e vendosjes për kërkesën në emër të dhimbjeve trupore-fizike, ka aprovuar kërkesën e paditëses në lartësinë e shpërblimit në shumë 1,275.00 €, ne raport me të paditurën e parë, si dhe shumën prej 425 euro në raport me të paditurën e dytë, ndërsa ka refuzuar shumën prej 1,300.00 euro, si tepër e lartë dhe se e tejkalon qëllimin e kompensimit të dëmit në rastin konkret. Vendimin e saj e ka bazuar sipas mendimit të ekspertëve mjekësor e dëmtuara-paditësja në këtë aksident të komunikacionit ka pësuar: kontuzione të kokës dhe të trurit, komucion të trupit, plagë shqyese në regjionin oksifital të kokës, dëmtime këto që konsiderohen lëndime të lehta trupore pa pasojë të përhershme për paditësen. a), Dhimbje fizike të intensitetit shumë të rëndë ka pasur 1 orë, b), dhimbje fizike të intensitetit të rëndë 24 orë, c), dhimbje të intensitetit të mesëm 7 ditë, d), dhimbje fizike të intensitetit të ulët 3 muaj, andaj duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve, kohëzgjatjen e shërimit që nënkupton edhe kohëzgjatjen e dhimbjeve, është vlerësuar se shumën e aprovuar është një satisfaksion dhe kompensim real për paditësen.

Për paditësen Vera Selimi, gjykata në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor ka aprovuar kërkesën për shpërblim e paditëses në lartësinë e shpërblimit në shumë 1,875.00 euro, ne raport me të paditurën e parë, si dhe shumën prej 625 euro në raport me të paditurën e dytë, ndërsa ka refuzuar shumën prej 2,500.00 euro, si tepër e lartë dhe se e tejkalon qëllimin e kompensimit të dëmit, vendimin e saj e ka bazuar sipas mendimit të ekspertëve mjekësor se e dëmtuara-paditësja në këtë aksident të komunikacionit është i shprehur si zvogëluar aktiviteti jetësor në shkallë prej 5%, në të cilin mendim nuk kanë pasur vërejtje palët ndërgjyqëse.

Për frikën e pësuar për paditësen Vera Selimi, gjykata ka aprovuar kërkesën për shpërblim në lartësinë e shpërblimit në shumë 1,125.00 euro, ne raport me të paditurën e parë, si dhe shumën prej 375.00 euro në raport me të paditurën e dytë, duke u bazuar në mendimin e ekspertëve mjekësor, përjetimin e aksidentit, natyrën lëndimeve të marra, si dhe kohëzgjatjen e shërimit, që nënkupton edhe frikën e përjetuar pasi te paditësja si pasojë e aksidentit është lajmëruar frikë sekondare e intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 2 deri 3 orë, e cila frikë ka kaluar në frikë sekondare e intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 6 javësh, ndërsa frikë sekondare të intensitetit të ulët ka zgjatuar prej një viti. Gjykata e ka refuzuar kërkesën e paditëses në shumën prej 1,000.00 euro, si shumë të lartë dhe e cila tejkalon qëllimin e shpërblimit të dëmit.

Gjykata në emër të shëmtimit trupor, për paditësen Vera Selimi ka aprovuar kërkesën për shpërblim në lartësinë e shpërblimit në shumë 1,875.00 euro, ne raport me të paditurën e parë, si dhe shumën prej 625 euro, në raport me të paditurën e dytë, ndërsa e ka refuzuar shumën prej 1,000.00 euro, si shumë të lartë dhe e cila tejkalon qëllimin e shpërblimit të dëmit, vendimin e saj e ka bazuar sipas mendimit të ekspertëve mjekësor e dëmtuara-paditësja në këtë aksident të komunikacionit ka marrë shëmtim të shkallës së ulët, për shkak të plagës shqyese në regjionin aksifital të kokës, me rastin e vlerësimit gjykata ka marrë parasysh edhe moshën e të dëmtuarës, si dhe natyrën e shëmtimit i cili është i dukshëm në pjesën e kokës.

Për paditësen Mimoza Selimi, gjykata në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor ka aprovuar kërkesën për shpërblim e paditëses në lartësinë e shpërblimit në shumë 12,000.00 euro, ne raport me të paditurën e parë, si dhe shumën prej 4,000.00 euro në raport me të paditurën e dytë, ndërsa ka refuzuar shumën prej 14,000.00 euro, si tepër e lartë dhe e tejkalon

qëllimin e kompensimit të dëmit, vendimin e saj e ka bazuar sipas mendimit të ekspertëve mjekësor e dëmtuara-paditësja në këtë aksidentin e komunikacionit është i shprehur si zvogëluar aktiviteti jetësor në shkallë prej 40%.

Për frikën e pësuar për paditësen Mimoza Selimi, gjykata ka aprovuar kërkesën për shpërblim të paditëses në lartësinë e shpërblimit në shumë 2,250.00 euro, në raport me të paditurën e parë, si dhe shumen prej 750 euro në raport me të paditurën e dytë, ndërsa ka refuzuar shumen prej 1,000.00 euro, si tepër e lartë dhe e tejkalon qëllimin e kompensimit të dëmit, duke u bazuar në mendimin e ekspertëve mjekësor, se te e dëmtuara pas aksidentit ka ekzistuar një frikë sekondare e intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 5 deri 6 orë, e cila është përcjellë me dëmtim të sistemit nervor, e cila frikë ka kaluar në frikë sekondare e intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 6 muaj, frikë e intensitetit të ulët ka ekzistuar për dy vite, e cila është manifestuar me rikujtim të aksidentit, frikë gjatë pjesëmarrjes në komunikacion këmbësor.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën V. të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, C.nr.273/11 të datës 21.05.2013, si në pikën II. ku detyrohet e paditura e parë K.S. “NN1”, që paditëses së dytë M.S., në emër të dëmit jo material ti paguaj për dhembjet e përjetuara fizike shumë prej 2,625.00 euro dhe shëmtimin 3,375.00 euro, në pikën IV. ku detyrohet e paditura e dytë K.S. “NN2”, që paditëses së dytë M.S., në emër të dëmit jo material t’ia paguaj për dhembjet e përjetuara fizike 875 euro dhe shëmtimin 1,125.00 euro.

Për paditësen Mimoza Selimi, gjykata e shkallës së dytë në emër të dhimbjeve trupore-fizike, ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, ku paditëses i është aprovuar kërkesa në lartësinë e shpërblimit në shumë 2,625.00 euro, në raport me të paditurën e parë, si dhe shumen prej 875.00 euro në raport me të paditurën e dytë, vendimin i shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar sipas mendimit të ekspertëve mjekësor, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve, kohëzgjatjen e shërimit që nënkupton edhe kohëzgjatjen e dhimbjeve, është vlerësuar se shuma e aprovuar është një satisfaksion dhe kompensim real për paditësen.

Gjykata e shkallës së dytë në emër të shëmtimit trupor, për paditësen Mimoza Selimi, ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, ku paditëses i është aprovuar kërkesa në lartësinë e shpërblimit në shumë 3,375.00 euro, në raport me të paditurën e parë, si dhe shumen prej 1,125.00 euro, në raport me të paditurën e dytë, vendimin e shkallës së parë është vlerësuar si i drejtë dhe i bazuar sipas mendimit të ekspertëve mjekësor, e dëmtuara-paditësja në këtë aksidentin e komunikacionit ka marrë shëmtim të shkallës së mesme, për shkak të vrazës operatore në regjionin e kokës, me rastin e vlerësimit gjykata ka marrë parasysh edhe moshën e të dëmtuarës, si dhe natyrën e shëmtimit i cili është në vend të dukshëm.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të shpërblimit të dëmit jo-material, paditëseve ja ka njohur të drejtën në kamatën si për mjetet e afatizuara në bankat komerciale në R. e Kosovës, për një vit pa destinim të posaçëm, nga datë 21.05.2013, deri në pagesën përfundimtare, në kuptim të nenit 277 paragrafi 1 të LMD-së².

² LMD-së-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978,

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se vendosja si në pikën V. të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, ku detyrohen të paditurat që paditëseve në emër të shpenzimeve kontestimore t'ua paguajnë shumën prej 5,200.00 euro, dhe atë e paditura K.S. "NN1", shumën prej 4,000.00 euro dhe K.S. "NN2", shumën prej 1,200.00 euro, është vendim i drejtë dhe i bazuar në neni 452.1, duke marrë parasysh shpenzimet e krijuara si dhe të specifikuara në parashtrësën e datës 31.05.2013, të cilat shpenzime janë krijuar gjatë procedurës, të njëjtat janë llogaritur në bazë të tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se vendosja si në pikën V. të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar sa i përket pjesës refuzuese të aktgjykimit të atakuar, është vërtetuar duke mbetur e pa shqyrtuar, pasi pala paditëse nuk ka ushtruar ankesë, ndërsa të paditurat nuk kanë interes që aktgjykimi të goditet në këtë pjesë.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar pretendime ankimore të cilat pjesërisht janë pranuar, sa i përket lartësisë së kërkesës për dëmin, të aprovuara nga shkalla e parë, ndërsa nuk është i bazuar pretendimi i të paditurës së parë sa i përket ndarjes së përgjegjësisë për shkaktimin e aksidentit nga të siguruarit e tyre, ku pretendon se shkaktar të aksidentit janë drejtuesit e dy automjeteve në aksidentin e komunikacion në shkallën 50:50, pasi nga shpjegimet e dhëna nga ekspertizat e komunikacionit të kryera në këtë çështje të cilat janë arsyetuar si më lartë, kemi të bëjmë me lëshime primare të drejtuesit të automjetit Passat, i cili ka qenë i siguarur te e paditura KS "NN1".

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 195 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 200 dhe 201, të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3460/2013, më datë 23.05.2016

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Fejzullah Rexhepi